

17.01.2018  
 - Ac. nr. 1072/18



VENDIMI ËSHTË I PLOTËDITSHËM  
 DHE I Detyrueshëm  
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
 FERIZAJ II UROSEVAC

Me DANA 14.01.2019

C.nr.888/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Ardian Ajvazi, në çështjen juridike, sipas padisë së paditësit [redacted] nga fshati [redacted] Komuna Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati [redacted], kundër të paditurës Komuna Ferizaj-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati [redacted] nga Ferizaj lidhur me kompensimin e tri pagave jubilarë dhe tri pagave përcjellëse, vlera e kontestit 2,691.78 Euro, me datë 11.12.2017, merr këtë:

**AKTGJYKIM**

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit [redacted] nga fshati [redacted], Komuna Ferizaj dhe DETYROHET e paditura Komuna e Ferizajt-Drejtoria e Arsimit që paditësit në emër të tri pagave përcjellëse pas pensionimit t'ia paguaj shumën prej 1,257.96 Euro dhe në emër të përvojës së punës mbi 40 vite në vlerë prej 150% të një page bazë dhe atë shumën prej 672.94 Euro si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 269.20 Euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit në shumën prej 87.93 Euro në emër të tri pagave pas pensionimit dhe shumën prej 672.95 Euro në emër të tri pagave jubilarë.

**Arsyetimi**

Paditësi përmes të autorizuarit të tij me datë 09.10.2017, ka parashtruar padi, kundër të paditurit, lidhur kompensimin e tri pagave jubilarë dhe tri pagave përcjellëse .

I autorizuari i paditësit në fjalën hyrëse deklaron: në tërësi ngeli si në kërkesëpadi dhe shtojmë se paditësi [redacted] ka punuar në cilësi të mësimdhënësit për me tepër se 30 vite, dhe atë nga data 19.09.1973 e deri në pensionim dhe si rrjedhim i njëjti ka përmbushur të gjitha kriteret dhe bazat ligjore për kërkesat e paraqitura në këtë kërkesëpadi, si provë pranë gjykatës është paraqitur edhe kontrata e punës e cila njëherit dëshmon lartësinë e pagës dhe gjithashtu dëshmon se i njëjti ka punuar në cilësinë e mësimdhënësit deri me datën 22.08.2017, dhe mbi këtë baze i njëjti ka fituar të drejtën që t'i paguhen pagat e kërkuara ne padi mbi bazën e kontratës kolektive, andaj i propozojmë gjykatës që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, gjithashtu i kërkojmë shpenzimet e kësaj proceduare kontestimore dhe atë për përpilim të

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve dhe provave të lartë cekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Nga provat e elaboruar më lartë përkatësisht Gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se paditësi ka përvojë të punës 42 vite dhe se dhe se i takon e drejta në realizimin e tri pagave përcjellëse pas pensionimit në shumën prej 1,257.96 Euro dhe në emër të përvojës së punës mbi 40 vite në vlerë prej 150% të një page bazë dhe atë shumën prej 672.94 Euro. Kjo është parapar në nenin 35 paragrafët 8 dhe 9 të Kontratës Kolektive të datës 18.04.2017.

Në bazë të Kontratës Kolektive të vitit 2017 paditësi reazlizon pas pensionimit tri paga përcjellëse në lartësinë e tri pagave sipas mesatarës së tri pagave të fundit e që është shumë e tërësishme prej 1,257.96 Euro (paga mesatare për tre muajt e fundit para pensionimit është 419.32 Euro), ndërsa shpërblimi jubilar për 40 vite e më shumë përvojë pune i takon e drejta për shpërblim jubilar në vlerë prej 150% të një page bazë. Paga bazë e paditësit është llogaritur ajo sipas kontratës së punës në shumë prej 448.63, ndërsa vlera e 150% të saj është 672.94 Euro.

Pagat e shërbyesve civile, sektorit të arsimit, i shëndetësisë etj, financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe Komuna e Ferizajt është orgazatë buxhetore e nivelit lokal. Kontrata Kolektive e lidhur ndërmjet SBASHK dhe Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë (Qeveria e Republikës së Kosovës) prodhon efekt juridike nga data e lidhjes së saj 18.04.2017 dhe e paditura si organizat buxhetore e nivelit lokal është e detyruar t'ia paguaj paditësit shumat si në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Nga faktet e treguara në padinë e paditësit si dhe nga provat dhe shkresat që gjenden në lëndë, rezulton si e bazuar kërkesëpadia e paditësit. Gjykata vërtetoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për të vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, e duke u bazuar në nenet 143 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJT

C.nr.888 /17, me datë 11.12.2017



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të kopjes së tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate.